

## EnveoPutz Silicat

SUVA DEKORATIVE ME  
PËRSHKUESHMËRI TË  
LARTË AVULLI DHE NGJITJE  
TË SHKËLQYER, PËR  
FASADA TË QËNDRUESHME

EnveoPutz Silicat është një suva silikate përfundimtare për dekorimin dhe mbrojtjen e sipërfaqeve të fasadave. Për shkak të përmbajtjes së lartë të silikatit dhe përshkueshmërisë ekstreme të avullit, rregullon natyrshëm lagështinë dhe mundësinë e zhvillimit të mikroorganizmave. Është i disponueshëm në një numër të madh ngjyrash në përputhje me katalogun e ngjyrave Enveo.

### Avantazhet e produktit:

- Përshkueshmëri e shkëlqyer e avujve
- Ngjitje fantastike me bazamentin
- Niveli i lartë i mbrojtjes nga algat dhe myku

### *Zona e aplikimit*

EnveoPutz Silicat është pjesë e sistemeve të fasadave Enveo me EPS dhe lesh guri. Ngjyrat me indeks HBW më të ulët se 30% duhet të përdoren vetëm për sipërfaqe më të vogla, si p.sh. dritare, dyer dhe hapje të tjera.



### Klasifikimi i produktit

V2-W2-0,3Mpa- $\lambda=0,82\text{W}/(\text{m}\cdot\text{K})$ -B-s2,d0

(EN 15824:2017)

### Përgatitja e sipërfaqes

Bazamenti mbi të cilin aplikohet produkti duhet të jetë i pastër, i fortë, i thatë, pa gjurmë vaji dhe yndyre, i fortë dhe pa pjesë që mund të shkëputen. Suvaja mund të aplikohet në bazamente me bazë gëlqereje dhe çimento, të trajtuara më parë me astar/bazë EnveoGrund. Suvatë me përzjerje çimento-gëlqere dhe betonet duhet të jenë të paktën një muaj të vjetër, me mbetje lagështie < 2%. Bazamentet me mbështetje të pamjaftueshme dhe pjesët që shkëputen, sipërfaqet e tretshme në ujë (gjatë largjes sipërfaqësore) duhet të eliminohen plotësisht dhe të riparohen me materialin e duhur. Sipërfaqet e kontaminuara me myk dhe alga duhet të lahen me ujë të nxehtë dhe të dezinfektohen me produkte të përshtatshme.

### Përgatitja dhe instalimi i produktit

1. Minimumi 24 orë para aplikimit të suvasë së fasadës bazamenti duhet të trajtohet me astar/bazë EnveoGrund me qëllim të përmirësimit të ngjitjes, rregullimit të përthithjes së ujit, përmirësimit të përshkueshmërisë së avujve dhe kohës së hapur të punës së suvasë. Astar/baza duhet të ngjyrosset në të njëjtën ngjyrë si suvaja e fasadës.
2. EnveoPutz Silicat duhet të përzihet mirë përpara përdorimit deri në fund në secilën kovë individualisht dhe më pas, të homogjenizohet materiali nga paleta dhe/ose paketime të ndryshme në një enë të madhe për unifikimin (barazimin) e ngjyrës. Për të arritur konsistencën e synuar të suvasë, sipas nevojës, shtoni maksimum 250 ml ujë të pastër në 25 kg produkte. Shtimi i mëposhëm i ujit dhe pigmentit nuk lejohet.
3. Suvaja e fasadës aplikohet me mallë çeliku në trashësinë e kokrrës më të madhe. Suva e aplikuar siç duhet duhet të përpunohet më

pas me mallë PVC ose metalike duke përdorur presion të lehtë në sipërfaqe me lëvizje rrethore ose të drejta në varësi të strukturës dhe pamjes së synuar. Aplikimi dhe përpunimi i suvasë duhet të kryhet në vazhdimësi që sipërfaqja të duket e qëndrueshme. Për performancë të suksesshme, është e nevojshme të përafrohet numri i aplikuesve në krahasim me numrin e kateve dhe sipërfaqes, në mënyrë që bashkimet e materialit të bëhen në gjendje të lagësht dhe të padukshme pas përfundimit.

4. Sistemi i fasadës duhet të sigurohet me profile dhe aksesore për të arritur mbrojtje të plotë nga depërtimi dhe kullimi i ujit në sipërfaqe. Produkti nuk duhet të përdoret në sipërfaqe horizontale ku mund të depozitohen papastërti, ujë dhe borë.
5. Gjatë instalimit dhe tharjes temperatura e sipërfaqes dhe e ajrit duhet të jetë ndërmjet 5°C dhe 30°C. Materiali duhet të mbrohet nga ndikimi i diellit, erës dhe shiut për të paktën 24 orë, periudhë pas së cilës arrihet rezistenca ndaj ndikimit atmosferik. Metoda e rekomanduar e mbrojtjes përfshin vendosjen e rrjetës të skelës, por mund të jetë e pamjaftueshme në rast se ndikimi ka intensitet të fortë. Në rast se kushtet e motit nuk përputhen me kërkesat; është e nevojshme të ndërpritet puna dhe të pritët kushtet optimale.

\* Të gjithë parametrat e deklaruar i referohen kushteve standarde të motit: temperatura 20°C, lagështia relative deri në 65%.

Prodhuesi rekomandon aplikimin në sipërfaqe të vogla për provë për t'u siguruar që produkti/bazamenti është përgatitur siç duhet dhe se janë siguruar kushtet e përshtatshme të përdorimit dhe instalimit. Nëse jo, ju lutemi ndaloni punën dhe kontaktoni përfaqësuesin e Saint-Gobain. Kompania nuk mban përgjegjësi për zbatimin e gabuar të punimeve me kete material si dhe përdorimin e materialit për qëllime që nuk janë përcaktuar në përshkrimin e produktit. Ankesat e paraqitura pas përfundimit të kryerjes së punëve nuk do të pranohen.

### Veglat e punës

Për përzierjen: mikser elektrik.  
Për aplikim dhe nivelim: Mallë çeliku dhe plastike, shpatull.

### Konsumi i produktit

Përafërsisht 2,5-3,5 kg/m<sup>2</sup> në varësi të kokërrzimit dhe llojit të fasadës.

### Ruajtja, magazinimi dhe transporti

Produkti EnveoPutz Silicat duhet të ruhet në paketim origjinal, të padëmtuar, në paleta të forta dhe funksionale, në hapësirë të thatë, pa ekspozim të drejtpërdrejtë ndaj borës, shiut, breshrit dhe diellit, të mbrojtur nga ngrica, në hapësirë të mbyllur ose të mbuluar.

Produkti nuk është i rrezikshëm për transport në kuptimin e të gjitha rregulloreve kombëtare dhe ndërkombëtare të transportit. Gjatë transportit, produkti duhet të mbrohet nga elementët. Transportoni dhe ruani produktin në temperaturë nga +5° C në +30° C.

### Siguria e produktit

Produkti nuk klasifikohet si i rrezikshëm. Paralajmërim! Gjatë punës me produktin mund formohen grimca të rrezikshme si rezultat i spërkajes. Mbroni rrugët e frymëmarrjes nga grimcat apo avujt.

### Karakteristikat teknike të produktit

Ngjyra e produktit: EnveoPutz Silicat është një suva e bardhë fasade që mund të ngjyroset në përputhje me kartën e toneve Enveo.

Paketimi: kovë plastike 25 kg, 600 kg në paletë.

Data e skadencës: 12 muaj nga data e prodhimit të shtypur në kovë.

Informacione të hollësishme mbi produktin, dokumentacionin shtesë dhe fletën e të dhënave të sigurisë janë të disponueshme në faqen zyrtare të internetit [www.saint-gobain.rs](http://www.saint-gobain.rs) dhe [www.saint-gobain.al](http://www.saint-gobain.al).

### Pastrimi

Mbetjet e produktit të freskët mund të pastrohen nga veglat dhe sipërfaqet me ujë. Produkti i ngurtësuar duhet të hiqet vetëm mekanikisht.

### Kufizimet e produktit

Suvaja e fasadës EnveoPutz Silicat nuk mund të përdoret në rrethanat e mëposhtme:

- Në sipërfaqe druri dhe metali
- Për aplikim në disa shtresa dhe mbi suva ekzistuese përfundimtare.
- Në temperatura ruajtjeje, transporti, aplikimi dhe tharje më të ulëta se +5° C dhe më të larta se 30° C,
- Në sipërfaqe që përmbajnë papastërti dhe lagështi
- Në sipërfaqet horizontale dhe çati.

## Mjedisi

Produkti i papërdorur dhe paketimi bosh nuk mund të hidhen jashtë vendeve të menaxhimit të mbetjeve. Shikoni fletën e të dhënave të sigurisë së produktit për më shumë informacion.

## Metoda e asgjësimit

Hedhja e përmbajtjes dhe paketimit në përputhje me rregulloret lokale. Hidhni veçmas paketimin dhe materialin e papërdorur. Mos lejoni depërtimin në sistemin e kanalizimit. Mos i hidhni së bashku me mbeturinat e zakonshme.

## Vendi i origjinës dhe prodhuesi i produktit

Vendi i origjinës: Republika e Serbisë

Prodhuesi: Saint-Gobain građevinski proizvodi d.o.o. Beograd, Bulevar 115, Mihajla Pupina, kati 5, 11070 Novi Beograd, Republika e Serbisë.  
Nr. Kontakti: 011 314 96 81.

Importues dhe distributor: Saint-Gobain Construction Products Albania shpk, Rr.Budull, Nr3, Fushe-Preze, Vore  
Nr. Kontakti: +355 69 20 24 002



**SAINT-GOBAIN GRAĐEVINSKI  
PROIZVODI D.O.O. BEOGRAD**

115d Bulevar Mihajla Pupina Street,  
V floor 11070 • Novi Beograd • Serbia  
Tel.: + 381 11 314 96 84  
info.rs@saint-gobain.com  
www.saint-gobain.rs

Informacioni teknik i paraqitur më sipër dhe rekomandimet bazohen në njohuritë dhe përvojën tonë, në rastet kur produkti ruhet, transportohet, përgatitet dhe përdoret në kushte të rregullta. Blerësi, ose përdoruesi i produktit këshillohet të testojë produktin, nëse është i përshtatshëm për përdorim për qëllimin e synuar. Duke marrë në konsideratë faktin, që nuk kemi ndikim në rrethanat e përdorimit dhe trajtimit të produktit, kompania nuk do të mbajë përgjegjësi për pasojat që vijnë nga përdorimi i parregullt. Blerësi, ose përdoruesi i produktit do të jetë përgjegjës në rast se produkti magazinohet, transportohet, përgatitet, përdoret dhe aplikohet në kundërshtim me udhëzimet, qëllimin, vetitë dhe informacionin mbi sigurinë e produktit, si dhe pas datës së caktuar të skadencës të produktit. Ekipi ynë i ekspertëve me përvojë ofron këshilla në fazat e planifikimit dhe aplikimit të produkteve tona. Vizita në kantierin e ndërtimit dhe demonstrimi i aplikimit të produkteve tona mund të organizohet sipas kërkesës. Kontaktoni ekipin tonë teknik dhe mësoni më shumë për produktet tona në faqen e internetit [www.saint-gobain.rs](http://www.saint-gobain.rs) dhe [www.saint-gobain.al](http://www.saint-gobain.al). Kjo fletë e të dhënave teknike është e vlefshme prej 01.03.2025 dhe zëvendëson të gjitha versionet e mëparshme për këtë produkt.



## PERFORMANCË QË I BËN BALLË ÇDO SFIDE

### **EnveoPutz Silicat**

është një suva e gatshme dekorative vetëpastruese me efikasitet të lartë, e cila është natyrshëm rezistente ndaj mikroorganizmave, rrezeve UV dhe ujit.

[www.testisthebest.com](http://www.testisthebest.com)

**Enveo** Therm

